



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1528 / Prot.
17

Patos më 20.06.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 14.06.2024

I mbajtur sot më datë 14.06.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Armand Ahmetaj
2. Albiona Lamaj
3. Klaudio Alisininaj
4. Erald Çepele
5. Artan Velçani
6. Smerald Hazizaj
7. Vjollca Kasaj
8. Ertilla Myrtaj
9. Novrus Toska
10. Zejni Musaj
11. Elton Seraj
12. Zejni Musaj
13. Gani Ahmetaj
14. Suela Hoxha

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Armand Ahmetaj.

Pasi verifikohet kuorumi i mbledhjes i cili plotëson 50 %+ 1 këshilltar kalohet në miratimin e rendit të ditës i cili është si më poshtë:

Armand Ahmetaj- Kuorumi ligjor është 14, vlerësohet si rregull për hapjen e

mbledhjes. Kjo mbledhje është thirrur në zbatim të nenit 53 pika 3 gërma a

të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe të

nenit 59 të "Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin të Këshillit

Bashkiak.

Mbledhja thirret me kërkesë të kryetarit të bashkisë e cila mban nr. 1528 prot datë 11.06.2024.

Rendi i ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.05.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.05.2024.
- 4- Projekt-vendim "Mbi projekt dokumentin e programit buxhetor Afatmesëm faza e parë 2025-2027".

Së fundmi janë paraqitur dhe dy projektvendime të tjera, të cilat para se të marim vendim për të miratuar rendin e ditës do të kërkohej miratimi që këto të shtohen në rendin e ditës.

Projekt-vendim "Për blerje rërë bituminoze për shtrimin rrugës nga Qendra e Siqecës deri në Qendrën e Drenies" me vlerë 3,003,588 lekë.

Projekt-vendim "Mbi miratimin e projektit "Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforsim bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave" me vlerë 39,730,565 lekë.

Do të kërkoja miratimin tuaj për ti shtuar këto dy pika në rendin e ditës.

Kush është dakord që ti shtojmë në rendin e ditës?

15 vota pro pasi është shtuar dhe një këshilltar tjetër (**Këshilltarja Elmira Rama**).

Kundër s'ka, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Enkejola Ajazi

Ajazi

Erald Cepelo

Klaudio Arsimani



KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1528 / Prot.
8

Patos më 20 .06.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 14.06.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.05.2024.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë vërejtje apo propozim për korrigjim procesverbali?
Nëse ska gjë tjetër e vlerësojmë të miratuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Enkelajda Ajazi
Ajazi

Erangel Gjepele

Kludio Alimani

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1529 / Prot.
19

Patos më, 20 06.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 14.06.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.05.2024

Armand Ahmetaj – Të lutem Refaela!

Refaela Xeba , Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 29.05.2024 janë marrë gjithsej 6 vendime nga numërat 41 deri në 46, të gjitha vendimet janë zbardhur në afat dhe janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 6 vendime vetëm vendimi me numër 43 i është përcjell prefekturës dhe na ka ardhur përgjigja se është në përputhje me ligjin.

Armand Ahmetaj- Po faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës

SEKRETARI
Refaela Xeba

Entekijola Ajazi
Ajazi
Eraldo Cepede
Kludio Alizani

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1524 Prot.
3

Patos më 20 .06.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 14.06.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi projekt dokumentin e programit buxhetor Afatmesëm faza e parë 2025-2027”.

Ekvektivi- Mimoza Shtëmabri, Drejtore e Financës relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Në bazë të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, “Për menaxhimin financiar në Republikën e Shqipërisë, udhëzimit nr. 23, “Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm standard kemi ndjekur gjithë fazat deri në arritjen e projekt-dokumentit të parë të fazës së parë për projekt-buxhetin afatmesëm 25-27. Projektvendimit i është bashkëlidhur relacioni dhe gjithë dokumenti shoqërues i cili përmban kopje të të gjithë manualit dhe dokumentave të hartuara në bazë të instrumentit financiar të miratuar nga Ministria e Financave. Lista e gjithë programeve në të cilat është kanalizuar buxheti për këto tre vjet. Tavanet përgatitor të cilat janë miratuar me vendim të këshillit dhe gjithë procedura që ka ndjekur grupi i menaxhimit dhe drejtuesit e programeve për të hartuar këtë dokument. Në dokument janë pasqyruar saktë në bazë të gjithë tabelave shoqëruese burimet të cilat janë të balancuara me shpenzimet, llojet e burimeve, shpenzimet, dhe prioriteti i grupit të menaxhimit për të hartuar këtë dokument afatmesëm i cili është rritja e shpenzimeve për investime. Duke ju referuar në mënyrë të përmbledhur materialit dhe tabelave shoqëruese kemi burimet që përbëjnë buxhetin afatmesëm që janë transferata e pakushtëzuar e cila nga viti 2025 deri në vitin 2027 vjen me rritje me 2.5 deri në 3.6% në 2027. Dhe në vlerë absolute është 182 milion në 2025, 192 milion në 2026 dhe 204 milion në 2027.

Po ashtu një nga burimet e tjera kryesore është dhe transferata e pakushtëzuar sektoriale e cila mbulon gjithë funksionet e transferuara në 2016 dhe vjen me 151 milion për 2025, 152 milion për 2026 dhe 153 milion për 2027. Theksoj se transferata sektoriale dhe e pakushtëzuara janë të përcaktuara dhe vijnë me udhëzim të Ministrisë së Financave çdo fillim viti buxhetor në bazë të formulës dhe në bazë të prodhimit të brendshëm bruto. Gjithashtu një nga burimet kryesore që zë dhe peshëm më të madhe në buxhetin afatmesëm janë parashikimi i të ardhurave vendore. Është parashikuar që për vitin 2025 të kemi 302 milion që vjen me rritje nga 2024, 308 milion për 2026 dhe e kemi ruajtur në një nivel të pandryshueshëm për 2027 për vet politikat e qeverisë dhe mund ti ndryshojmë gjatë dokumentit përfundimtar. Në material janë të shprehura qartë pesha specifike që zënë shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik dhe burimet në vlerë absolute dhe në përqindje gjatë gjithë burimeve të përgjithshme. Trendi i këtij buxheti është që pesha specifike e burimeve nga të ardhurat tona vjen duke u rritur dhe nga 44% që sot zë peshën specifike në buxhetin aktual 2024 ne kemi një rritje me 47% për vitet e buxhetit afatmesëm. Në këtë dokument shihet qartë se shpenzimet janë planifikuar duke i dhënë rëndësi shpenzimet për investime të cilat nga 24% shkojnë në 27% 26 dhe 27 duke ulur shpenzimet e personelit në shpenzime operative. Në projektdokumentin afatmesëm është pasqyruar gjithë aktivitetet dhe produktet që ka çdo program. Buxheti është i kanalizuar dhe programuar në 15 programe.

Programit që i është kushtaur rëndësi në këtë buxhet afatmesëm janë shërbimet bujqësore dhe infrastruktura rrugore dhe shërbimet publike të cilat zënë peshën kryesore dhe peshëm më të madhe në % në propocion me gjithë programet e tjera. Në material është pasqyruar dhe niveli i shpenzimeve që vjen më një trend rritës për shpenzimet kapitale dhe është për 2025 6.5% për 2026 8.96 % dhe për 2027 11.2%. Në një nga tabelat shoqëruese që vjen e gjeneruar dhe nga instrumenti financiar sipas përcaktimit të Ministrisë së Financave janë investimet që janë parashikuar prioritarë për këtë dokument në fazën e parë të cilat janë projekt ide në bazë të fishave dhe janë me objekte të pasqyruara në materialin që ju keni në dispozicion. Gjithashtu në dokument keni dhe treguesit financiar duke dal qartë sa është pesha specifike e të ardhurave tatimore nga ato jotatimore, e transfertës së pakushtëzuar nga totali i burimeve, i specifikes nga totali i burimeve, i tarifave nga gjithë burimeve dhe gjithë treguesit e tjerë që janë të përcaktuar si tregues nga Minsitria e Finacave dhe në udhëzimin e përgatitjes së buxhetit afatmesëm. Përsa përket parashikimit të të ardhurave në këtë buxhet afatmesëm është parashikuar rritja e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke forcuar strukturat dhe mirë administrimin dhe rritur bazën e tatueshmë. Gjithmonë kemi menduar që lehtësojmë dhe përjashtojmë nga pagesa e taksave sipas politikave lehtësuese kategoritë që janë në nevojë. Materiali i gjithë është vënë në dispozicion.

Armand Ahmetaj- Kjo çështje ka kaluar në shqyrtim në komisionin e Ekomonisë dhe ka mar miratimin unanimit për të kaluar në votim në këshill.

Ekvektivi- Mimoza Shtëmabri, Drejtore e Financës relatton materialin e paraqitur me shkrim.


Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje?

Meqënëse nuk kemi propozoj ta kalojmë në votim projekt-vendim "Mbi projekt dokumentin e programit buxhetor Afatmesëm faza e parë 2025-2027".

Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska, kundër ska, miratohet.

SEKRETARI
Refaela Xeba



KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 1538/1 Prot.
13

Patos më 20 06.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 14.06.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për blerje rërë bituminoze për shtrimin rrugës nga Qendra e Siqecës deri në Qendrën e Drenies" me vlerë 3,003,588 lekë.

Ekzekutivi- Ermenita Mici- relatton materialin e paraqitur me shkrim. Përshëndetje të gjithëve! Pas disa dëgjësave publike që ka realizuar bashkia Patos në Njësinë Administrative Ruzhdie ku një ndër kërkesat më të shumta të banorëve ka qenë shtrtimi i kësaj rruge. Për zgjidhjen e këtij problemi ne kemi menduar realizimin e shtrimit me rërë bituminoze për shkak se është një segment problematik përsa i takon gjërësisë së rrugës dhe kushtevë të tjera. Dhe si zgjidhje më e mirë e mundshme për këtë rrugë duke pasur parasysh dhe fluksin e kalimtarëve në zonë është menduar shtrimi me rërë bituminoze. Vlera për shtrimin e kësaj rruge që është një segment që do të përfshi rrugën nga qendra e Siqecës deri në qendrën e Drenies është 3,003,588 lekë dhe fondi për mbulimin e blerjes së rërës bituminoze do të jetë brenda programit të shërbimeve urbane duke përdorur një pjesë të fondit të parashikuar për blerjen e asfaltbetonit. Në këto kushte kërkojmë miratimin e blerjes së rërës bituminoze për shtrimin rrugës nga qendra e Siqecës deri në qendrën e Drenies me vlerë 3,003,588 lekë dhe duke paraqysh qe ky fond do jetë brenda programit të shërbimeve.

Artan Velçani- Dua të shpreh vlerësimin tim për këtë rast. Ka ardhur koha që ne të mbylлим një problem të atyre banorëve dhe ftoj ta miratojmë.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim?

Atëherë kalojmë në votimin e pikës së pestë projekt- vendim "Për blerje rërë bituminoze për shtrimin e rrugës nga qendra e Siqecës deri në qendrën e Drenies" me vlerë 3,003,588 lekë. Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska , kundër ska, miratohet.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 15374 Prot.
13

Patos më 20.06.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 14.06.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi miratimin e projektit “Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforsim bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave” me vlerë 39,730,565 lekë.

Ekzekutivi- Ermenita Mici- reklaton materialin e paraqitur me shkrim.

Ky projektvendim ka të bëjë me aplikimin që ka realizuar bashkia Patos në programin “Fonde për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore”. Projekti për të cilin ne kemi aplikuar është muri mbajtës me struktura metalike si dhe përforsimin e bazamentit dhe rikonstruksionin e rrugës që do të ndërhyhet dhe do të dëmtohet përgjatë kësaj procedure. Për zgjidhjen e këtij problemi duke shmangur aktivizimin e mëtejshëm të rrëshqitjeve të dherave e cila mund të dëmtojë si banesat nën kuotën e murit dhe ato që ndodhen mbi kuotën e murit që mund të rrezikojnë shëmbjen si rezultat i aktivizimit të shkarjes së dherave, kemi menduar një zgjidhje me realizimin e një perde metalike me konstruksion që janë specifikisht palankola. Është menduar si një zgjidhje më e përshtatshme pasi zgjidhjet e tjera si realizimi i mureve beton arme kërkojnë një ndërhyrje më të madhe dhe zona është mjaft kritike që mund të shkaktoj dhe demtimin e rrugës si dhe mund të jetë e vështirë për mbajtjen në kontroll të procesit të rrëshqitjeve të dherave. Muri që do të realizohet ka një gjatësi prej 65 ml si dhe rruga që mund të preket nga kjo ndërhyrje me sip prej 350m². Në këto kushte ky projekt do të financohet nga AKMC, pjesa tjetër që përfshinë oponencën e projektit, mbikqyrjen dhe kolaudimin do të mblulohen nga bashkia Patos.

Kryetari i Bashkisë- Projekti që është fituar nga AKMC është bërë me mur palankola, mur metalik. Janë struktura metalike që ngulen deri në 15 metra në tokë dhe po aq sa është muri rrinë mbi tokë. Kjo gjë është përzgjedhur në mënyrë të tillë pasi muri më beton që bëhet është e pamundur që të kalojnë makineritë e rënda pa e dëmtuar rrugën. Në momentin që do kalojnë makineritë e rënda ajo rrugë rrezikon qëndrueshmërinë dhe mund të bjeri bashkë me pallatin. Se në krah të rrugës është dhe një pallat 5-katësh. Prandaj është zgjedhur dhe ky lloj muri dhe projekti që është aplikuar në janar në mos gaboj tani erdhi dhe miratimi nga AKMC për financimin 100% të projektit duke nisur dhe nga rrezikshmëria që ka aktualisht. Në një pjesë të rrugës ka vajtur 30-40% po vete afer mesit të rrugës demtimi nga shkarja e dherave. Me kalimin në këshill do mbyllet në një kohë më të shkurtër. Gjithashtu do bëhet dhe sistemimi i rrugës që do jetë përgjatë gjithë pjesës që do shtrihet muri.

Ndërsa për rërën bituminoze që është bërë për Siqec Drenie duke qënë se kishte një kosto shumë të madhe shtrimi me asfalt për komplet pjesën e rrugës nga siqeca deri në Drenie u pa e arsyeshme që të përdoret rërë bituminoze duke u nisur edhe nga fakti se kalimi i mjeteve në atë rrugë është në nivel fare të ultë, vetem mjete bujqësore kalojnë dhe makinat e qytetarëve që kanë tokat atje. Është parë e arsyeshme që të bëhet si rrugë për efekt të personave që kanë tokat atje si dhe ditën e premtë shkojnë qytetarët tek mekami i Drenies.

Artan Velçani- Shpreh falenderimet për këtë hap të Bashkisë.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim?

Atëherë kalojmë në votimin e pikës së gjashtë projekt-vendim "Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforsim bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave" me vlerë 39,730,565 lekë.

Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska , kundër ska, miratohet.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Enterejda Azizi
Azizi

Erabel Gepele

Kludio Arbnoraj



KRYETARI
Armand Ahmetaj

